



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .11.2024

MBLEDHJA Nr. 45,
Datë 06.11.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 06.11.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 45 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr.306, datë 30.11.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts (CEP)” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW
2. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “ORHER” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI